



BASHKIA
TIRANË

KRYETARI

VENDIM

Nr. 43810/1 datë 05/11/2021
PËR

**“NDËRMARRJEN E NISMËS PËR RISHIKIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM
VENDOR (PPV) PËR TË BASHKISË TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 14, nenit 64, shkronja “a”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 13, pika 1, shkronja “b”, nenit 26, pika 2, të ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar; nenit 11, nenit 12, të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” tw ndryshuar; vendimit të KKT-së nr. 1, datë 14.04.2017 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tiranë” i ndryshuar; VKM Nr. 427, datë 08.06.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjensisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Udhëzimit Nr.01, datë 22.02.2019 të Agjensisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, për “Për hartimin, bashkrendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore me procedurë të thjeshtuar”

V E N D O S:

1. Të ndërmarrë nismën për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ky vendim të botohet në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit dhe ne faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij.
3. Ngarkohen, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria Juridike, Aseteve dhe Licensimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erion Veliaj

